



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2532/Prot.
12

Tiranë, më 15. 7. 2020

URDHËR

Nr. 237, Datë 15. 7. 2020

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË,
“MASTER I SHKENCAVE”, NË “ARKITEKTURË”, NË UNIVERSITETIN E NEW
YORK-UT TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Arkitekturë” me 300 kredite dhe kohëzgjatje normale 5 vite akademike (10 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi të integruar lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Arkitekturë”, në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në Universitetin e New York-ut Tiranë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Arkitekturë”, në Universitetin e New York-ut Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut Tiranë të përmbushë plotësimet/rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, sipas raportit të vlerësimit, bashkëlidhur këtij urdhri, përpara fillimit të veprimtarisë akademike të programit të studimit.
4. Universiteti i New York-ut Tiranë të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjisllacionin në fuqi.

5. Universiteti i New York-ut Tiranë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Besa SHAHINI

Tiranë më 12.07.2020

RAPORT RIVLERËSIMI

Për hapjen e programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë
Master i Shkencave në "ARKITEKTURE"
Universiteti New York Tirana

Në vijim të dokumentacionit plotësues të dërguar nga UNYT në datë 07/07/2020 me prot.
Nr. 156. 2020, konstatohet:

- Është bërë plotësimi për syllabus-in GP 598. Mungon citimi i referencave të përdorura në hartimin e këtij syllabusi;
- Një pjesë e syllabus-eve të paraqitura, vijon ende të mos jetë në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM nr. 41. Dt. 24/01/2018;
- Është plotësuar materiali në lidhje me numrin e studentëve dhe kapacitetet përkatëse në raport me infrastrukturën e disponueshme. Në vijim të ecurisë së programit do të lindë nevoja për zgjerimin e mëtejshëm të këtyre kapaciteteve;
- Nuk është paraqitur dokumentacion për mënyrën e mirëmbajtjes dhe higjienizimit të ambienteve;
- Universiteti ka dhënë informacion suplementar mbi fondin e bibliotekës, si dhe ka listuar burimet për bibliotekën "soft". Në vijim do të jetë e nevojshme të sigurohet literatura e rekomanduar në syllabus-et e lëndëve;
- Universiteti ka vënë në dispozicion informacionin mbi format e komunikimit, të cilat vlerësohen efikase dhe lehtësisht të aksesueshme si nga studentët dhe nga publiku i gjerë;
- Universiteti dëshmon se ka një rrjet aktiv partnerësh lokalë dhe ndërkombëtarë;
- Universiteti dëshmon që disponon kapacitetet dhe strukturat e përshtatshme për menaxhimin e programit të studimit të propozuar dhe për sigurimin e cilësisë.

Bazuar në konstatimet e mësipërme dhe mbështetur në raportin paraprak (dt. 26.06.2020), vlerësojmë se programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në "ARKITEKTURE" i paraqitur nga UNYT plotëson standardet dhe kriteret minimale për hapjen.

Vlerësuesit e jashtëm: 